REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr._____Prot. Maliq, më 23.09.2026

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 2, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e hënë **më datë 28 09.2026, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (kuorumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara datë (20.08.2026) dhe (01.09.2026)
4.Miratimi i mendimit zyrtar të Këshillit Bashkiak Maliq dhe përcjellja e tij pranë Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, në kuadër të procesit të rishikimit të ndarjes administrativo-territoriale.Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë.
5.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2026";
6.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
7.P-V"Për shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e strukturës dhe bonitetit të tokës për pasuritë në pronësi të shoqërisë *"TOPTANI CSE";*
8.P-V "Për miratimin e dhënies në përdorim të përkohëshëm të disa pronave të paluajtshme publike në pronësi/përdorim të Bashkisë Maliq, subjektet *"Fastnet Albania"* sh.p.k, me qëllim zhvillimin e projketit "*Për ndërtimin e rrejtit inxhinerik telefonik me fibër optike Gpon dhe Epon"*;
9.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2.datë, 08.01.2026 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminstratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026"; i ndryshuar.
10.Informacion për Raportin e II-të të Monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2026";
11.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e premte me datë 25.09.2026 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare. Pika 4 e rendit të ditës: znj.Pranvera Begolli, z.Petrit Kupe, z.Kristina Malelli, z.Yllson Ibrahimllari, znj.Eglantina Balli.

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut. Pikat 5, 6 të rendit të ditës:z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 8, 9, 10 të rendit të ditës:z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedist dhe Biodiversitetit. Pika 7 e rendit të ditës: z.Lulëzim Hoxhaj, z.Fevri Sherifi, z.Selami Muço, znj.Rovena Terolli, znj.Albina Xhejo

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pika 8 e rendit të ditës: z.Idlir Limllari, znj.Pranvera Begolli, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi, z.Selami Muço.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI